Raporti monitorues i keqinformimit për muajin nëntor

2022

dhjetor 2022

Action for
Democratic Society
hibrid.info

Raporti monitorues i keqinformimit për muajin tetor

Publikues: ADS/hibrid.info

Prishtinë, dhjetor 2022

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.
Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

Ky raport është publikuar nga Action for Democratic Society (ADS) në kuadër të projektit "Promovimi i gazetarisë objektive dhe lufta kundër dezinformimit", që mbështetet nga National Endowment for Democracy (NED).
Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e ADS-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NED-it.

Projketi financohet nga:

NED NATIONAL ENDOWMENT FOR DEMOCRACY

Projekti realizohet nga:

Action for Democratic Society

Përmbajtja

01. Kategoritë vlerësuese të keqinformimit

02. Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

03. Llojet e fushave tematike

04. Llojet e publikuesve

05. Klasifikimi i mediave në aspektin gjeografik

06. Figurat dhe Institucionet më të përfolura

Hyrje

Ky raport përmbledhës dhe përshkrues, i pari i këtij lloji në Kosovë deri më tash, pasqyron gjendjen e informimit (keqinformimit) gjatë muajit nëntor 2022, bazuar në të dhënat e siguruara nga platforma për kontroll të fakteve – hibrid.info. Formati i këtij raporti është monitorues dhe paraqet gjendjen për një periudhë njëmujore, ndërsa ky është raporti i pestë mujor i publikuar deri më tash.

Ky raport është i ideuar nga platforma për kontroll të fakteve hibrid.info, pjesë e OJQ-së kosovare "Action for Democratic Society" (ADS) dhe mbështetët nga fondacioni amerikan "National Endowment for Democarcy" (NED) në kuadër të projektit "Promovimi i Gazetarisë Objektive dhe Luftimit të Dezinformatës".

Në kuadër të raportit jepet një pasqyrë për formën e informimit mediatik me ngjarjet për dhe rreth Kosovës. Në vazhdën e këtij raporti paraqiten disa figura (grafika) të dala nga baza e të dhënave të hibrid.info e ndarë përmes disa kategorive të vlerësimit që janë pjesë e metodologjisë për kontroll të fakteve të kësaj platforme.

Raporti trajton 5 kategori krahasuese të të dhënave, duke synuar të jep një sqarim më objektiv të gjendjes së informimit dhe për të shpjeguar tendencat e keqinformimit për këtë periudhë monitoruese.

Kategoritë monitoruese janë:

-Vlerësimet e artikujve keqinformuese

-Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

-Institucionet dhe personat e përfolur në artikuj keqinformues

-Llojet e mediave që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese

-Hapësira gjeografike e mediave që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese

Përmbajta e trajtuar nga hulumtuesit e hibrid.info e që ka shërbyer për ndërtimin e këtij raporti është kryesisht ajo e publikuar në gjuhën shqipe dhe serbe.

1 Kategoritë vlerësuese të keqinformimit

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas kategorive vlerësuese



Monitorimi gjatë muajit nëntor 2022 tregon se numri më i madh i artikujve keqinformues të publikuar janë vlerësuar si "Clickbait" me 31% dhe "Përmbajtja e paverifikuar" me 25%. Për herë të parë që kur ka filluar të bëhet monitorimi i keqinformimit në Kosovë në muajin korrik 2022, këtë muaj publikimet e vlerësuara si "Dezinformatë" janë renditur në vendin e tretë, ndërsa në muajt paraprakë ishte gjithnjë në vendin e parë apo të dytë krahas vlerësimeve "Clickbait".



31% e artikujve keqinformues kanë marrë vlerësimin "Clickbait".

1.1 Analizë e llojeve të vlerësimeve

01. Clickbait

Në kuadër të kësaj kategorie vlerësimi, gjatë muajit nëntor, janë publikuar artikuj keqinformues kryesisht në fushën e politikës dhe sigurisë, si njohja e Kosovës, bashkimi kombëtar, dialogu Kosovë-Serbi, zhvillimet rajonale etj. Disa prej artikujve në këtë kategori janë publikuar nga mediat vendore, kurse pjesë më e madhe nga media të dyshimta.

02. Përmbajtje e pa verifikuar

Edhe në këtë kategori kanë mbizotëruar artikuj keqinformues me tematikë politike e të sigurisë për dialogun Kosovë-Serbi dhe publikime të pasakta, të nxitura nga Serbia për gjendjen e komunitetit serb në Kosovë. Publikimet me përmbajtje të paverifikuar janë publikuar nga mediat vendore dhe rajonale.

03. Dezinformatë

Prej muajin korrik 2022, kur hibrid.info ka nisur monitorimin e artikujve keqinformues, dhe deri në muajin tetor 2022, kategoria "Dezinformatë" është renditur e para apo e dyta për nga numri i publikimeve me përmbajtje keqinformuese. Por, kjo ka ndryshuar në muajin nëntor 2022 kur ka shumë më pak lajme të vlerësuara si dezinformatë. Gjatë kësaj periudhe, në këtë kategori janë publikuar artikuj për raportet Kosovë-Serbi, veriun e Kosovës dhe disa lajme tjera në fushën e sportit e ekonomisë.

04. Lajm i rremë

Shumica e artikujve me përmbajtje të lajmeve të rreme janë publikuar nga media të dyshimta. Ato kanë trajtuar tema të ndryshme, si dhuna e ushtruar fizike kundër të moshuarës në shtëpinë e të moshuarve në Pejë, pensionistët e skemat sociale, COVID-19, si dhe rolin e SHBA-së në raportet mes Kosovës e Serbisë.

05. Gabim

Artikujt e vlerësuar në këtë kategori gjatë muajit nëntor 2022 i përkasin temave për veriun e Kosovës, parkingun nëntokësor në Prishtinë dhe për ekipin kombëtar të Zvicrës në futboll. Ato janë publikuar nga media vendore dhe nga kombinimi i mediave vendore/rajonale.

06. Teori konspirative

Edhe pse në numër më të vogël, të gjithë artikujt që kanë marrë vlerësimin e teorisë konspirative janë publikuar nga media në gjuhën serbe, duke keqinformuar për Kosovën. Këto publikime ishin të fokusuara për rolin e Rusisë në Ballkan, veriun e Kosovës dhe marrëdhëniet mes Kosovës e Serbisë.

Artikuj të tjerë me përmbajtje keqinformuese janë listuar në kategoritë "Manipulim i fakteve" dhe "Mashtrim", si dhe nga kombinimi i vlerësimeve "Clickbait / Gabim", "Dezinformatë / Lajm i rremë", "Përmbajtje e paverifikuar / Dezinformatë" dhe "Teori konspirative / Manipulim i fakteve". Artikujt keqinformuese e vlerësuar, kanë përmbajtje me tema për çështje sociale, të sigurisë dhe politikës lidhur me zhvillimet në Kosovë.

2 Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese



Gjatë muajit nëntor 2022, ngjashëm si në muajin tetor, numri më i madh i artikujve keqinformues ka mbizotëruar për marrëdhëniet ndërmjet Kosovës e Serbisë, ngjarjet për e rreth veriut të Kosovës, deklarimet e pakonfirmuara të lidershipit serb se fluturake pa pilotë (dronë) kanë fluturuar pranë kazermave të ushtrisë serbe në afërsi të kufirit me Kosovën dhe për komunat me shumicë serbe. Këto përmbajtje keqinformuese janë publikuar kryesisht nga mediat serbe në pretendimet e tyre të pasakta se Kosova po kërkon luftë dhe eliminimin e komunitetit serb në veri, se me ndihmën e NATO-s po tentohet të luftohet kundër serbëve në veri dhe lajme të tjera me këtë tematikë. Përveç artikujve në fushën politike dhe të sigurisë, edhe dhuna fizike e ushtruar ndaj gruas së moshuar në shtëpinë e të moshuarve në Pejë kishte bërë shumë bujë në Kosovë gjatë muajit nëntor.

42% e temave kryesore kanë qenë për raportet Kosovë-Serbi, veriun e Kosovës, dhunën fizike ndaj të moshuarës, dronët, komunat me shumicë serbe, marrëdhëniet Kosovës e SHBA-së, rolin e Turqisë në raportet Kosovë-Serbi dhe bashkimin kombëtar.

2.1 Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese / sipas javëve

Java e parë e tetorit

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas temave, gjatë javës së parë të tetorit



Java e dytë e tetorit

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas temave, gjatë javës së dytë të tetorit



Java e tretë e tetorit

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas temave, gjatë javës së tretë të tetorit



Java e katërt e tetorit

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas temave, gjatë javës së katërt të tetorit



Temat më të trajtuara gjatë tetorit, sipas javëve

JAVA E PARË

1. Dhuna fizike ndaj të moshuarës
2. Dronët
3. Veriu
4. Dëmtimi i varrezave serbe

JAVA E DYTË

1. Raportet Kosovë-Serbi
2. Raportet Kosovë-SHBA
3. Njohja e Kosovës
4. Rusia në Ballkan

JAVA E TRETË

1. Veriu
2. SHBA në raportet Kosovë-Serbi
3. Turqia në raportet Kosovë-Serbi
4. Bashkimi kombëtar

JAVA E KATËRT

1. Veriu
2. Raportet Kosovë-Serbi
3. Komunat me shumicë serbe
4. Dialogu Kosovë-Serbi

2.2 Analizë e kontrolleve të fakteve sipas temave

Shumica e artikujve keqinformues të publikuar gjatë këtij muaji kanë trajtuar temat politike dhe të sigurisë. Të dhënat se dëshmojnë se raportet ndërmjet Kosovës e Serbisë, veriu i Kosovës dhe artikujt keqinformues për komunat me shumicë serbe, të publikuara kryesisht nga mediat serbe, kanë qenë temat kryesore në këtë muaj monitorues. Edhe dhuna fizike ndaj gruas së moshuar në Pejë ka qenë në fokus të mediave, ndërsa mediat serbe e shfrytëzuan në raportimet e tyre keqinformuese.
Në vijim shpjegohen përmbledhtazi katër temat kryesore të publikuara nga media të ndryshme në bazë të monitorimit të hibrid.info përmes metodologjisë së kontrollit të fakteve.

01. Raportet Kosovë-Serbi

Publikimet në këtë temë janë vlerësuar si dezinformatë, teori konspirative dhe kombinimi i kategorive dezinformatë / lajm i rremë. Pothuajse të gjithë artikujt për këtë temë janë publikuar nga mediat serbe, në të cilat trajtohen pretendime të pasakta e të pavërteta se institucionet e Kosovës kanë kërkuar ndihmë nga NATO për luftë kundër serbëve, se kryeministri i Kosovës ka kërcënuar me ushtri pa ofruar fakte se për çfarë kërcënimi bëhet fjalë dhe keqinformime të tjera të kësaj natyre.

03. Dhuna fizike ndaj të moshuarës

Rasti i dhunës së ushtruar ndaj të moshuarës kosovare nga disa infermiere në shtëpinë e të moshuarve në Pejë, ishte keqpërdorur nga mediat serbe për të shpërndarë artikuj keqinformues. Këto të fundit, duke tentuar që rastit t'i jepnin konotacione të incidentit ndër-etnik, pretendonin pa fakte se e moshuara ishte e komunitetit serb, e rrahur nga një infermiere shqiptare. Madje, edhe disa media spanjolle kishin publikuar artikuj keqinformues, se e moshuara ishte serbe, të cilat me sa duket kishin qenë të ndikuara nga mediat serbe. Këto nuk ishin të vërteta meqë e moshuara është shqiptare e Kosovës, që vërtetohet përmes identitetit të saj, si dhe pas këtij rasti, ajo ishte strehuar tek familjarët e saj, ku përmes video-xhirimeve dëshmohet se fliste në gjuhën shqipe.

02. Veriu

Edhe për zhvillimet në veriun e Kosovës, artikujt keqinformues janë publikuar nga mediat serbe, të cilat janë vlerësuar si përmbajtje e paverifikuar, dezinformatë dhe teori konspirative. Përmes tyre pretendohet pa fakte për dërgimin e 40 automjeteve të Policisë së Kosovës në veri dhe se kryeministri Kurti po kërkon luftë dhe eliminimin e serbëve. Gjithashtu, gjatë këtij muaji një aktivist serb i shoqërisë civile në veri pretendonte, po ashtu pa fakte, se ishte sulmuar nga Policia e Kosovës, gjë që ishte mohuar nga kjo e fundit dhe rasti është ende duke u hetuar nga Inspektorati Policor i Kosovës.

04. Asociacioni i komunave me shumicë serbe

Në këtë tematikë janë shpërndarë artikuj keqinformues të mediave serbe, në bazë të deklarimeve të pasakta të përfaqësuesve të Zyrës për Kosovën në Qeverinë serbe, se komuniteti serb në Kosovë po ndjehet i frikësuar në vendbanimet e banuara me shumicë serbe. Këto publikime janë vlerësuar si manipulim i fakteve dhe teori konspirative / manipulim i fakteve.

3 Llojet e fushave

Monitorimi i bërë gjatë muajit nëntor 2022 ka treguar se më së shumti publikime keqinformuese ka pasur në fushën e politikës me 38% dhe të sigurisë me 25%. Këto dy fusha së bashku përbëjnë 63% të artikujve keqinformues për këtë muaj monitorues, duke mbizotëruar dukshëm mbi temat tjera. Ato pasohen nga fushat sociale (20%), sporti (5%), ekonomia (4%) etj.

FUSHAT KRYESORE

Këtu janë renditur 6-të fushat kryesore



Përqindja kaq e lartë e artikujve keqinformues në fushën politike dhe të sigurisë gjatë këtij muaji është e pritshme marrë parasysh marrëdhëniet e tensionuara mes Kosovës e Serbisë dhe zhvillimet rreth dialogut mes të dyja shteteve. Në këtë drejtim, Serbia ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të kundërshtuar vendimin e Qeverisë së Kosovës për targat e automjeteve të komunitetit serb në Kosovë dhe po ashtu tendencën e saj, që përmes mediave të kontrolluara nga pushteti në Serbi, të shkaktojë tensione në komunat veriore të Kosovës. Kjo ka nxitur edhe interesin e audiencës kosovare për artikuj të këtyre tematikave, ndërsa politika e siguria janë pasuar nga artikuj keqinformues për çështje sociale, sporti, ekonomia e fusha të tjera.

Lidhur me artikujt në fushën politike, një pjesë e tyre janë publikuar nga mediat e Kosovës dhe të Serbisë, varësisht prej temave që kanë trajtuar, ndërsa shumica janë shpërndarë nga portale të dyshimta. Por, analizimi i të dhënave të publikimeve keqinformuese në fushën e sigurisë, tregon se shumica e tyre janë publikuar nga mediat serbe në pretendimet e tyre të pabazuara në fakte në raport me Kosovën dhe duke tentuar të japin një perceptim të shtrembëruar për gjendjen e komunitetit serb në Kosovë. Ngjashëm si në muajin tetor, edhe në këtë periudhë njëmujore monitoruese, mediat e Kosovës kanë shpërndarë më tepër artikuj keqinformues për fusha të tjera, si çështjet sociale, sporti, ekonomia, shëndetësia etj.

92% e përmbajtjeve keqinformuese ndërlidhen me fushat e politikës, sigurisë, çështjeve sociale, sportit dhe ekonomisë.

4 Llojet e publikuesve

DALLIMI NË PËRQINDJE NË MES TË PORTALEVE TË DYSHIMTA DHE ATYRE REALE





60% e krijuesve dhe publikuesve të përmbajtjes keqinformuese janë mediat reale.

5 Klasifikimi i mediave në aspektin gjeografik



Kjo matje tregon vetëm mediat reale që kanë krijuar dhe shpërndarë përmbajtje keqinformuese, duke i kategorizuar ato sipas vendit (shtetit) ku janë të regjistruara si entitete.

Kategorizimi i mediave në aspektin gjeografik është bërë sipas kësaj metode: mediat vendore të regjistruara në Kosovë, mediat rajonale, ndërkombëtare dhe ato që menaxhohen nga aktivistë të diasporës, por që kanë përmbajtje në gjuhën shqipe rreth zhvillimeve në Kosovë.

Në bazë të monitorimit për muajin nëntor 2022, mediat reale në Kosovë kanë krijuar e shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese prej 50%, të cilat pasohen nga mediat në rajon (44%), prej të cilave pothuajse të gjitha janë serbe, kombinimi i mediave vendore/rajonale (3%) dhe mediat ndërkombëtare (3%).

Gjatë këtij muaji nuk vërehet se mediat në gjuhën shqipe të diasporës të kenë shpërndarë lajme keqinformuese rreth Kosovës.

Për mediat e dyshimta mungojnë informacione për vendin e origjinës dhe nuk dihet nëse janë të regjistruara apo jo si entitete, prandaj ato nuk janë përfshirë në këtë matje.

5.1 Analiza e artikujve të kësaj kategorie

Në këtë matje analizohen artikujt keqinformues të publikuar në media, në varësi të vendit ku ato operojnë dhe ku janë të regjistruara si entitete juridike. Në vijim është përshkrimi i ndërlidhjes së tyre mes kategorizimeve dhe domethënia e tyre.

01. Mediat vendore

Mediat e Kosovës kanë publikuar përmbajtje keqinformuese të vlerësuar në kategoritë clickbait, përmbajtje e paverifikuar, gabim dhe lajm i rremë. Këto publikime kategorizohen në fusha të ndryshme, si politikë, siguri, ekonomi, sociale, shëndetësi, arsim dhe sport.

02. Mediat rajonale

Të gjithë artikujt e mediave rajonale janë publikuar nga mediat serbe gjatë kësaj periudhe monitoruese. Këto publikime i përkasin fushës së politikë dhe sigurisë, ndërsa janë vlerësuar sipas këtyre kategorive: përmbajtje e paverifikuar, manipulim i fakteve, dezinformatë, teori konspirative, përmbajtje e paverifikuar / dezinformatë, dezinformatë / lajm i rremë dhe teori konspirative / manipulim i fakteve.

03. Mediat vendore / rajonale

Ky kombinim i mediave është bërë për shkak se gjatë këtij muaji monitorues, disa media në Kosovë e Shqipëri kanë publikuar një artikull keqinformues me përmbajtje të njëjtë, i vlerësuar si gabim, për disa zhvillimeve në veri të Kosovës. Vetëm një artikull keqinformues është vërejtur se u publikua në muajin nëntor 2022 nga ky kombinimi i mediave vendore / rajonale dhe bëhet fjalë për suspendimin e tashmë ish-drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Policisë në veri të Mitrovicës, Nenad Gjuriq.

04. Mediat ndërkombëtare

Edhe tek mediat ndërkombëtare ka qenë vetëm një artikull keqinformues për Kosovën për raportimet e pasakta të mediave spanjolle për sulmin fizik ndaj të moshuarës në Pejë. Ky publikim është vlerësuar si manipulim i fakteve, i bazuar, me aq sa duket, në keqinformimet e shpërndara nga mediat serbe për këtë rast.

6 Figurat dhe institucionet më të përfolura

Ky seksion i raportit monitorues mat të dhënat se cilat kanë qenë institucionet dhe personalitetet (figura publike e politike) më të përfolura në bazë të monitorimit të artikujve me përmbajtje keqinformuese.



Institucionet më të përfolura, siç vërehet në figurën e mësipërme, ndërlidhen në kontekst të zhvillimeve politike dhe të sigurisë në Kosovë në bazë të artikujve keqinformues, të cilat në shumicën e rasteve janë publikuar nga mediat serbe dhe në numër dukshëm më të vogël nga mediat kosovare.

Nga të dhënat rezulton se Policia e Kosovës është ndër më të përfolurat për pretendimet e pabazuara në fakte të një aktivisti serb të shoqërisë civile në veri të Kosovës se është sulmuar nga Policia dhe për gabimet në raportim të mediave vendore e rajonale (të Shqipërisë) për suspendimin e ish-drejtorit rajonal të Policisë në veri të Mitrovicës, i cili në kohën kur po bëhet fjalë ishte vetëm i suspenduar, ndërsa shkarkimi i tij erdhi më vonë. Ngjashëm si në muajin tetor, Zyra për Kosovën e Qeverisë serbe ka qenë prej institucioneve më të përfolura edhe këtë muaj dhe kjo në bazë të deklarimeve të pakonfirmuara e të pasakta të shefit të kësaj zyre rreth Kosovës dhe komunitetit serb. Ajo pasohet nga artikujt keqinformues për Bashkimin Evropian dhe shtëpinë e të moshuarve "Orenda", ku ishte sulmuar fizikisht e moshuara në Pejë.

Institucionet të tjera të përfolura kanë qenë KFOR, institucionet të Kosovës, si Policia e Kosovës / Ministria e Punëve të Brendshme / Ministria e Mbrojtjes / Presidenca etj.



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, edhe gjatë këtij muaji monitorues ka qenë personaliteti më i përfolur nga artikujt keqinformues. Mediat serbe e kanë përfolur më së shumti Kurtin në pretendimet e tyre të pabazuara për sulm kundër serbëve dhe raportime tjera sa i përket veriut të Kosovës. Kurti, po ashtu, është vënë edhe në kontekst të figurave tjera politike, si me presidentin serb, Vuçiq e Përfaqësuesin e Lartë të BE-së për Politikë të Jashtme e Siguri, Borrell, por edhe me ministrat Sveçla dhe Mehaj. Një figurë tjetër e përfolur ka qenë e moshuara në Pejë, ndaj së cilës ishte ushtruar dhunë fizike nga infermieret në shtëpinë e të moshuarve.
Persona të tjerë të përfolur ishin ambasadori i SHBA-së në Kosovë, Jeffrey M. Hovenier, presidenti serb, Aleksandër Vuçiq etj.

Metodologjia

Për hartimin e këtij raporti monitorues janë përdorur metodat kuantitative dhe ato kualitative.
Sa i përket metodave kuantitative, fillimisht është krijuar baza e të dhënave nga ADS/hibrid.info me qëllim të zbërthimit dhe analizimit të detajuar të trendëve të keqinformimit. Përmes kësaj baze të të dhënave, e cila mirëmbahet dhe përditësohet në bazë të rregullta ditore nga stafi i ADS/hibrid.info, monitorohen rregullisht artikujt me përmbajtje keqinformuese.
Kjo nënkupton se të gjitha artikujt e publikuar në platformën hibrid.info vendosen në bazën e të dhënave dhe kjo e fundit shërben ndër burimet kryesore për përgatitjen e raportit monitorues. Për më tepër, metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave të paraqitura në raportin monitorues bën të mundur filtrimin e të dhënave në baza ditore, javore e mujore dhe atë në formë kryesisht kuantitative për të kuptuar më qartë fenomenin e keqinformimit të atyre artikujve të analizuar për këtë periudhë monitoruese njëmujore sipas kategorive e vlerësimeve të ndryshme.
Krahas kësaj, një burim tjetër i rëndësishëm për këtë raport është metodologjia e ADS/hibrid.info (e publikuar në faqen e hibird.info) për luftën kundër dezinformatës dhe lajmeve të rreme. Metodologjia, e cila është e bazuar para së gjithash në metodat kualitative, është hartuar nga stafi profesional i ADS/hibrid.info dhe është në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare për kontroll të fakteve, gjegjësisht sipas udhëzimeve të Rrjetit Ndërkombëtar për Kontroll të Fakteve (IFCN). ADS/hibrid.info është anëtarë me të drejta të plota në këtë mekanizëm ndërkombëtar - IFCN.
Ky raport monitorues përfshin periudhën nga 1 deri më 31 tetor 2022.

Ky raport i shkurtër me format monitorues, paraqet një pasqyrë të gjendjes njëmujore të informimit (keqinformimit) gjatë muajit nëntor 2022, nga të dhënat e platformës për kontroll të fakteve – hibrid.info.

Përfundime

Gjatë muajit nëntor 2022, më së shumti artikuj me përmbajtje keqinformuese janë publikuar në kategorinë vlerësuese clickbait me 31%, e cila pasohet nga kategoria përmbajtje e paverifikuar me 25% dhe dezinformatat me 9%. Në kategorinë "Clickbait" janë publikuar artikuj në fushën e politikës dhe sigurisë, si njohja e Kosovës, bashkimi kombëtar, dialogu Kosovë-Serbi etj. Pjesa më e madhe e këtyre artikujve janë publikuar nga media të dyshimta dhe në përqindje më të vogël nga mediat vendore. Vlerësime "Përmbajtje e paverifikuar" kanë marrë keqinformimet me tematikë politike e të sigurisë për dialogun Kosovë-Serbi dhe pretendime të pasakta për komunitetin serb në Kosovë, të publikuara prej mediave vendore dhe atyre serbe. Sa i përket kategorisë "Dezinformatë", kanë mbizotëruar temat për raportet Kosovë-Serbisë, veriu i Kosovës dhe lajme në fusha të tjera të publikuara nga media të dyshimta dhe mediat serbe. Risia e monitorimit për muajin nëntor 2022 është se, për dallim prej raporteve monitoruese të muajve paraprakë (korrik-tetor 2022), në këtë muaj janë publikuar më pak artikuj keqinformues si dezinformatë, duke e vënë këtë kategori në vendin e tretë për nga numri i publikimeve.

Temat më të përdorura për keqinformim gjatë këtij muaji kanë qenë raportet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, veriu i Kosovës, sulmi fizik ndaj të gruas së moshuar në Pejë, komunat me shumicë serbe, dronët, raportet Kosovë-SHBA etj. Këto publikime kryesisht janë shpërndarë nga mediat serbe. Matja e të dhënave në baza javore tregon se gjatë javës së parë të nëntorit, temë kryesore ishte sulmi fizik ndaj të moshuarës nga infermieret në shtëpinë e të moshuarve në Pejë me 29%, pasuar nga dronët me 14% dhe veriu i Kosovës me 7%; në javën e dytë të nëntorit kanë mbizotëruar raportet Kosovë-Serbi dhe raportet Kosovë-SHBA me 15%; gjatë javës së tretë, temat keqinformuese më të trajtuara ishin për veriun e Kosovës, si dhe roli SHBA-së e Turqisë në marrëdhëniet e Kosovës me Serbinë me gjithsej 8% secila prej tyre; ndërkaq, në javën e fundit të nëntorit kanë dominuar sërish temat për veriun e Kosovës, raportet Kosovë-Serbi dhe komunat me shumicë serbe në Kosovë me 13% secila prej tyre. Të dhënat nga monitorimi tregojnë se në muajin nëntor fushat kryesore të trajtuara nga mediat për shpërndarjen e artikujve keqinformuese kanë qenë në fushën e politikës me 38%, sigurisë 25% dhe sociale me 20%.

Edhe gjatë muajit nëntor më shumë artikuj me bazë keqinformuese ishin publikuar nga mediat reale me 60% se sa nga portalet e dyshimta me 40%. Analizimi i të dhënave për publikimet e mediave reale dëshmon se 50% e tyre ishin shpërndarë nga mediat kosovare, 44% nga mediat rajonale, si dhe 3% nga mediat vendore / rajonale dhe ato ndërkombëtare. Mediat vendore kanë publikuar artikuj keqinformues të vlerësuar si clickbait, përmbajtje e paverifikuar, gabim dhe lajm i rremë në fushën politike, të sigurisë, ekonomisë etj. Mediat rajonale, kryesisht ato serbe, kanë publikuar përmbajtje në fushën e sigurisë dhe politikës, duke shpërndarë publikime pa fakte e të pasakta për zhvillimet rreth Kosovës, të kategorizuara si përmbajtje e paverifikuar, manipulim i fakteve, dezinformatë, teori konspirative etj.

Mediat kanë shpërndarë më së shumti keqinformime për Policinë e Kosovës gjatë këtij muaji sa i përket zhvillimeve në veriun e vendit. Ajo pasohet nga Zyra për Kosovën e Qeverisë serbe, duke përfolur deklaratat e pavërteta e të pakonfirmuara të kreut të kësaj zyre rreth Kosovës. Institucionet tjera të përfolura ishin misioni KFOR dhe institucionet kosovare. Marrë parasysh peshën e funksionit të tij, kryeministri Albin Kurti ka qenë personaliteti më i përfolur edhe këtë muaj dhe atë kryesisht prej mediave serbe në pretendimet e tyre të pabazuara për veriun të Kosovës dhe komunitetin serb në vend.

HIBRID.INFO